



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo



Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Državna Agencija za Zaštitu Ličnih Podataka
National Agency for Protection of Personal Data

Nr. 16/12
Datë: 29.08.2012

Në mbështetje të nenit 49, paragrafi 1, pika 1.5 të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 70/2010) Mbikëqyrësit e Agjencisë morën këtë:

V E N D I M

1. **Këshillohet** Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF) në Vushtrri, që të gjenden hapësira të sigurta për vendosjen dosjet e pacientëve, me qëllim të parandalimit të qasjes së paautorizuar.
2. **Këshillohet** Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF) në Vushtrri, që të nxjerrë akte të brendshme për procedurat dhe masat e vendosura për sigurinë e dosjeve të pacientëve si dhe të emërohen në formë të shkruar personat kompetentë që janë përgjegjës për dosjet si dhe personat të cilët për shkak të natyrës së punës duhet të kenë qasje në këto dosje.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e pranimin të vendimit.

Arsyetim

Në bazë të nenit 46, paragrafi 1 dhe nenit 47, paragrafi 1 të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në tekstin e mëtejme LMDHP), Agjencisë ka realizuar inspektim të rregullt në QKMF- Vushtrri më datën 17.08.2012.

Inspektimi është bërë në hapësirat e objektit të vjetër dhe të ri të QKMF-së. Fokus i inspektimit kanë qenë dosjet e pacientëve të cilat në objektin e vjetër ishin të vendosura në korridor, ndërsa në objektin e ri dosjet e pacientëve ishin të vendosura në një korridor i cili është lehtë i qasshëm edhe nga pacientët si dhe kalimtarët e rastit në korridor.

Në bazë të nenit 14 nën-paragrafi 1.1 dhe 1.3 të LMDHP institucionet detyrohen që të mbrojnë lokalet si dhe të parandalojnë çfarëdo qasje të paautorizuar ose leximin e të dhënave personale gjatë ruajtjes.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo



Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Državna Agencija za Zaštitu Ličnih Podataka
National Agency for Protection of Personal Data

Në bazë të nenit 16, paragrafi 2 të LMDHP përcaktohet që institucioni në këtë rast QKMF-Vushtrri, duhet të nxjerrë akte të brendshme lidhur me procedurat dhe masat e vendosura për sigurinë e të dhënave personale si dhe të emërojë në formë të shkruar personat kompetentë që janë përgjegjës për dosjet e pacientëve. Po ashtu në formë të shkruar të emërohen edhe personat që për shkak të natyrës së punës së tyre kanë qasje në dosjet e pacientëve.

Siç është përshkruar në arsyetimin e lartcekur dhe bazuar në nenit 49, paragrafi 1.1. dhe 1.3. të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, mbikëqyrësit shtetërorë kanë marrë vendimin e paraqitur në dispozitiv.

Këshillë Juridike

Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa por mund të hapet konflikt administrativ në gjykatën kompetente në afatin prej 30 ditësh.

Mbikëqyrës Shtetërorë
Državni Nadzornici

Aleksandar Spasić

Beqim Demiri



Vendimi i dërgohet:

- Anëtarëve të Këshillit të Agjencisë
- QKMF Vushtrri
- Arkivit të Agjencisë